



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:045337

Datë: 24.01.2025

Numri i dokumentit: 06754889

KE.nr. 91/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Q.P dhe G.P me adresë në ..., Komuna Rahovec, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Fisnik Sogojeva, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës E.L.M Technische Dienstverlening B.V., me seli në Holandë, me objekt kontesti zhëmtim nga baza mospërmbushje e kontratës, vlera e objektit e pacaktuar, në seancën përgatitore të datës 24.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësve Q.P dhe G.P me adresë në ..., Komuna Rahovec, e paraqitur me datë 30.10.2017, ndaj të paditurës E.L.M Technische Dienstverlening B.V., me seli në Holandë, me objekt mospërmbushje e kontratës, e evidentuar me numër KE.nr. 91/22.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit Q.P dhe G.P, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 30.10.2017, pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega Rahovec kanë paraqitur, ndaj të paditurës E.L.M Technische Dienstverlening B.V. për shkak të mospërmbushjes së kontratës.

Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega Rahovec me Aktvendimin C.nr. 361/17, të datës 11.12.2017 është shpallur jo kompetente për të vendosur në këtë çështje kontestimore, ndërsa lëndën e ka dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Ndërsa, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë ka kaluar pranë Dhomave të shkallës së parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, sipas kompetencës lëndore të kësaj gjykate.

Kjo gjykatë, me datë 24.01.2025, ka caktuar seancën përgatitore në këtë çështje juridike mes paditësve Q.P dhe G.P dhe të paditurës E.L.M Technische Dienstverlening B.V.

Në seancën përgatitore të caktuar me datë 24.01.2025, nuk ka prezantuar përfaqësuesi i paditësve edhe përkundër se ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, i cili ftesën për seancën përgatitore e ka pranuar me datë 10.01.2025, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar. Ky fakt është konstatuar nga ana e gjykatës përmes fletë kthesës së Postës së Kosovës e cila gjendet në shkresa të lëndës.

Duke qenë se paditësi ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës lidhur me datën e mbajtjes së seancës përgatitore, mirëpo që nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata në mbështetje të nenit 409.1 të më të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësve Q.P dhe G.P të paraqitura ndaj të paditurës E.L.M Technische Dienstverlening B.V., e cila pranë kësaj gjykate është evidentuar me numër KE.nr. 91/22.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata në kuptim të nenit 450 të LPK-së, vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nënti 409.1 dhe 450 të LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 91/22, datë 24.01.2025

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.